

VENDIM
Nr. 46, datë 28.3.2014

PËR SHQYRTIMIN E VKM-së NR. 1101, DATË 28.12.2013 “PËR MIRATIMIN E GARANCISË QEVERTARE, TË LËSHUAR NË FAVOR TË RAIFFEISEN BANK ALBANIA SHA, NË KUADËR TË KUSHTEVE TË KONTRATËS SË KREDISË, NDËRMJET KËSAJ BANKE DHE KESH SHA”, SI EDHE VKM-së NR. 1102, DATË 28.12.2013 “PËR MIRATIMIN E GARANCISË QEVERTARE, TË LËSHUAR NË FAVOR TË INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, NË KUADËR TË KONTRATËS SË HUAS, NDËRMJET KËSAJ BANKE DHE KESH SHA”

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Z. Arben Ahmetaj kryetar
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare
- Z. Edmond Ademi anëtar
- Z. Ahmet Mançellari anëtar
- Znj. Anduena Dedja anëtare,

në mbledhjen e tij të datës 28.3.2014, mori në shqyrtim dy akte nënligjore të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave: VKM nr. 1101, datë 28.12.2013 “Për miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Raiffeisen Bank Albania sh.a., në kuadër të kushteve të kontratës së kredisë, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a.”, dhe VKM nr. 1102, datë 28.12.2013 “Për miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., në kuadër të kontratës së huas, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a.”.

OBJEKTI: Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore në VKM-në nr. 1101, datë 28.12.2013 dhe VKM-në nr. 1102 datë 28.12.2013.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, si dhe VKM-ja nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit””.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. KESH sh.a. është një ndërmarrje, forma juridike e së cilës është shoqëri anonime me 100% kapital shtetëror. Ndërmarrja ka si objektiv prodhimin dhe garantimin e energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët fundorë tariforë dhe luan një rol aktiv në tregun e energjisë.

2. KESH sh.a. ka partner/klient kryesor kompaninë “CEZ Shpërndarje”. Detyrimet e prapambetura janë akumuluar që nga viti 2011 dhe përfshijnë faturat e papaguara për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve tariforë, për mbulimin e humbjeve dhe importin e realizuar. KESH sh.a. i është drejtuar bankave tregtare për sigurimin e kredisë së nevojshme për blerjen e energjisë elektrike dhe furnizimin e konsumatorëve.

Ministria e Financës, me dy vendime të Këshillit të Ministrave, ka miratuar garancinë qeveritare në favor të Raiffeisen Bank Albania sh.a. dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., në kuadër të kushteve të kredisë ndërmjet këtyre bankave dhe KESH sh.a.

3. Në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, masa përbën ndihmë shtetërore, nëse përmblen në mënyrë kumulative kushtet: a) aktivizohen burime shtetërore; b) jepet një avantazh ekonomik; dhe c) sjell pasoja mbi konkurrencën.

a) Burime shtetërore

Sipas nenit 34 të ligjit për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas¹, miratimi i garancisë shtetërore për huan nuk përbën detyrim të drejtpërdrejtë për shtetin, por përfaqëson një detyrim të mundshëm të tij. Miratimi i garancisë shtetërore aktivizon potencialisht burime shtetërore.

b) Avantazhi ekonomik

Sipas legjislacionit evropian², garancia shtetërore konsiderohet se nuk jep një avantazh ekonomik për një

¹ Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”.

² Njoftimi i Komisionit mbi zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së për ndihmën shtetërore në formën e garancisë 20.6.2008.

ndërmarrje, nëse përmbushen në mënyrë kumulative kushtet: I) huamarrësi nuk është në vështirësi; II) garancia lidhet me një transaksion financiar specifik; III) garancia nuk mbulon më shumë se 80% të huas; dhe IV) për garancinë paguhet një çmim tregu.

I) Sipas rregullores për ndihmën shtetërore për shpëtim dhe ristrukturim³, si edhe mbështetur në të dhënat ekonomiko-financiare për periudhën 2010-2012, ndërmarrja KESH sh.a. nuk konsiderohet një ndërmarrje në vështirësi.

II) Garancia e lëshuar nga Ministria e Financave lidhet me një transaksion të përcaktuar financiar, për një shumë të caktuar maksimale, e cila është e kufizuar në kohë deri në kthimin e plotë të të gjitha shumave që KESH sh.a. u detyrohet bankave.

III) Sipas legjislacionit që zbatohet në sektorin e energjisë⁴, organizimi i tregut të energjisë elektrike dhe funksionimi i sistemit elektro-energjetik realizohet si shërbim publik. KESH sh.a., si furnizues publik me shumicë, është i vetmi subjekt i licencuar në vend për blerjen e energjisë elektrike nga gjenerimi publik, prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike apo prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike dhe tregtuesit, për nevojat e klientëve tariforë.

IV) KESH sh.a. i ka kërkuar në treg të hapur bankave tregtare ofertat fillestare për shumën dhe termat kryesorë të akordimit të kredisë. Primi dhe normat e interesit, të ofruara nga bankat, reflektojnë normën e tregut. Ofertat kanë qenë objekt i rishikimit lidhur me kushtet e kredisë dhe nga ndërmarrjes është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme.

Miratimi i garancisë shtetërore për lidhjen e marrëveshjes së kredisë, nuk i jep KESH sh.a. avantazh ekonomik.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 17, shkronja “d”, dhe 25, 29, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1101, datë 28.12.2013 “Për miratimin e garancisë qeveritare”, të lëshuar në favor të Raiffeisen Bank Albania sh.a., në kuadër të kushteve të kontratës së kredisë, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a.”, dhe VKM nr. 1102, datë 28.12.2013 “Për miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., në kuadër të kontratës së huas, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a.”, nuk përbëjnë ndihmë shtetërore.

2. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ahmetaj

³ VKM nr. 816, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim””, neni 3, shkronja “a”.

⁴ Ligji nr. 9072 datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 25 dhe VKM nr. 338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”.